

Mr. Rejhan Neziri

IDETË SOCIO-POLITIKE TË FARABIUT

Farabiu (Ebu Nasr Muhammed b. Muhammed b. Tarhan b. Uzluk) i lindur në krahinën Farab të Turkistanit më 870 dhe i vdekur në Damask rreth vitit 950, ka qenë ndër filozofët dhe mendimtarët e mëdhenj islamë që në botën latine të Mesjetës është njohur me emrin Alfarabius apo Avennasar. Ai është quajtur “Mësuesi i dytë / Magister secundus” pas Aristotelit i cili është quajtur “Mësuesi i parë / Magister primus”.¹ Është filozofi i parë që është orvatur të bëjë pajtimin e filozofisë klasike greke, sidomos të filozofisë politike greke me Islamin.²

Sipas disa burimeve thuhet se Farabiu ka shkruar më se njëqind vepra, një numër i konsiderueshëm i të cilave kanë të bëjnë me logjikën, metafizikën, fizikën, etikën dhe politikën.³

Veprat në të cilat Farabiu i shpreh qartë dhe në tërësi idetë e tij socio-politike janë: *es-Sijāsetu 'l-Medenijeh*, *el-Medīnetu 'l-Fādileh*, *Tahsīlu 's-Se'ādeh* dhe *Fusūlu 'l-Medenijj*.⁴

Shoqëria - domosdoshmëria dhe qëllimi i saj

Duke u mbështetur në mësimet antike greke lidhur me njeriun si *zoon politikon* (qenie shoqërore / politike), Farabiu flet për domosdoshmërinë e krijimit të shoqërisë pa të cilën jeta e njeriut si individ do të ishte e pamundshme. “Çdo njeri është krijuar me një natyrë (*el-fitrah*) e cila ka

¹ Farabiu, *es-Siyāsetu 'l-Medeniyye* veya *Mebādiu 'l-Mevcūdāt*, (tani e tutje *es-Siyāseh*), Parathënia e përkthyesve turq M. Aydın dhe të tjerët, Stamboll, bot. Kültür Bakanlığı, 1980.

² Farabiu, *el-Medīnetü 'l-Fāzıla (İdeal Devlet)*, (tani e tutje *el-Medīneh*) Parathënia e përkthyesit turk Ahmed Arslan, Ankara, bot. Vadi, 1997.

³ Ndër veprat më të rëndësishme të tij numërohen: *Risāletun fi 'l-'Akl* (Traktat mbi arsyen / intelektin); *Ihsāu 'l-'Ulūm* (Klasifikimi i shkencave); *Ujūnu 'l-Mesāil* (Burimet e çështjeve); *et-Tenbīh 'alā Sebīli 's-Se'ādeh* (Kahëzimi në rrugën e lumturisë); *Tahsīlu 's-Se'ādeh* (Fitimi i lumturisë); *Fusūlu 'l-Medenijj* (Klasat e qytetarit / shtetasit); *el-Xhem 'u Bejne Re'jej el-Hakīmejn Eflatūn ve Aristutālis* (Pajtimi i ideve të dy filozofëve: Platonit dhe Aristotelit); *el-Medīnetu 'l-Fādileh* (Qyteti i virtutshëm / Shteti ideal); *es-Sijāsetu 'l-Medenijeh* (Udhëheqja e qytetit / Politika). Në dy veprat e fundit që për nga tematika janë mjaft identike me njëra-tjetrën, Farabiu i shpreh në tërësi idetë e tij filozofike. Këtu ai nuk e trajton vetëm filozofinë politike por, për më tepër, i shpreh edhe idetë e tij lidhur me metafizikën dhe psikologjinë racionale. Në sistemin e Farabiut, i cili në të vërtetë duhet të trajtohet në tërësi, nuk ekziston mundësia për ndarjen e metafizikës prej fizikës, politikës prej etikës, etikës prej psikologjisë. P.sh., në qoftë se nuk merren në konsideratë idetë e Farabiut lidhur me ontologjinë, nuk do të mund t'i kuptonim drejtë as edhe idetë e tij lidhur me psikologjinë, etikën dhe politikën. Sido që të jetë, ne këtu do të orvatemi t'i paraqesim idetë sociologjike dhe politike të tij duke i ndërlidhur me mendimet e përgjithshme të tij të lëmvive të tjera me qëllim që ta vëmë në pah pozitën e këtij mendimtari të madh në historinë e mendimit njerëzor.

⁴ Er, İzzet, *Din Sosyolojisi*, Ankara, bot. Akçağ, 1998, f. 16; Sharif, M. M., *Historija Islamske Filozofije*, v. II, Zagreb, bot. August Cesarec, 1990, f. 111.

nevojë për shumë gjëra lidhur me vazhdimësinë e llojit të vet dhe lidhur me arritjen e përsosurisë më të lartë. Ai s'ka mundësi që të gjitha këto t'i sigurojë vetë. Përkundrazi, ai ka nevojë për shumë njerëz: çdonjëri prej të cilëve do t'ia mbulonte një nevojë të tij të veçantë. Nga ky aspekt të gjithë njerëzit kanë të njëjtën pozitë ndaj njëri-tjetrit. Kështu, çdo individ këtë nevojë natyrore të tij për t'u përkryer mund ta realizojë vetëm përmes bashkëjetesës me njerëz të ndryshëm. Si rezultat i një kontributi të këtillë të gjithmbarshëm të shoqërisë sigurohen mjetet përmes të cilave individi e vazhdon sojin e vet dhe e arrinë përsosurinë më të lartë.”⁵

Ekzistojnë disa lloje të grupimeve të këtilla njerëzore, mirëpo të gjitha këto mund të ndahen në të përkryera dhe të papërkryera. “Shoqëritë e përkryera ndahen në: të mëdha, të mesme dhe të vogla. Shoqëri e madhe është ajo ku të gjithë popujt bashkëjetojnë në mbarë botën e banueshme. Shoqëri e mesme është ajo ku në një pjesë të kësaj bote jeton vetëm një popull (*el-mil-leh*) dhe shoqëri e vogël është ajo ku në tokën e cilitdo popull banon popullata e vetëm një qyteti. Tubimi i popullatës së një fshati, të një lagjeje, të një rruge dhe së fundi të një shtëpie që njëherit është njësia më e vogël, përbëjnë shoqëritë e papërkryera, të gjymta dhe joideale. Edhe lagjja edhe fshati ekzistojnë për qytetin, ndërsa relacioni i fshatit me qytetin ka karakter shërbimi. Pastaj, lagjja është një pjesë e qytetit dhe është në relacion me të. Rruga është pjesë e lagjes, kurse shtëpia e rrugës. Qyteti është pjesë e tokës ku banon një popull, kurse populli është pjesë e të gjitha shoqërive që jetojnë mbi faqen e dheut.”⁶

Këtu mësojmë se nuk bëhet fjalë vetëm për qytetet-shtete, porse ekzistojnë edhe kombet-shtete, madje edhe një shtet universal që mund t'i përfshijë të gjitha viset e banueshme të sipërfaqes tokësore. Shteti ideal nuk është e thënë të jetë i kufizuar në përmasa të një qyteti (*polis*) ashtu siç pretendonin Platoni dhe Aristoteli. Ai mund të jetë i përngjashëm me një perandori të madhe si ajo romake apo ajo sasanide, bile mund të jetë edhe një shtet universal, gjithbotëror. Farabiu lidhur me këtë i përdor termat *el-medīnetu 'l-fādileh*, *el-ummetu 'l-fādileh* dhe *el-umemu 'l-fādileh*. Me termin *el-medīneh* mund të nënkuptohet edhe qyteti-shtet (*polisi*) edhe çfarëdo shoqërie e organizuar, çfarëdo *res publica* e pavarur politikisht dhe e udhëhequr mirë. Mirëpo, ai në të gjitha shkrimet e tij me këtë term nënkupton shtetin pa marrë parasysh madhësinë e tij.⁷ Me këtë rast duhet përkujtuar se Farabiu duke i ndjekur paraardhësit e tij antikë nuk bën ndonjë dallim midis shtetit dhe shoqërisë.*

Duke vënë në pah se qëllimi i krijimit të shoqërisë, gjegjësisht i tubimit dhe i organizimit të individëve në grupe shoqërore është vazhdimi i llojit njerëzor dhe arritja e lumturisë, që nënkupton arritjen e një shkalle të përkryerjes ku shpirti njerëzor nuk ndjen nevojë më për materien, Farabiu konstaton se ky qëllim së pari mund të arrihet në qytet. “E mira më e lartë (*el-hajru 'l-efdal*) dhe përkryerja më e madhe së pari arrihen vetëm në qytet e kurrsesi jo në një bashkësi më të vogël se qyteti” thekson ai. “Mirëpo, meqë edhe e mira edhe e keqja mund të arrihen si rezultat i zgjedhjes dhe vullnetit (të individëve), ekziston mundësia që një qytet të krijohet si një organizëm ku njerëzit bashkëpunojnë për arritjen e disa qëllimeve të këqija. Sipas kësaj, lumturia nuk mund të fitohet në çfarëdo qyteti qoftë. E pra, qytet i virtytshëm, i përkryer

⁵ Farabiu, *el-Medīneh...*, f. 99-100. Krahaso këtë konstatim me: Platoni, *Shteti*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1980, libri II, 369 b. (Të dhënat për veprën e Platonit janë dhënë sipas faqosjes ndërkombëtare). Idetë e njëjta apo të ngjashme të *Shtetit* të Platonit me ato të Farabiut tani e tutje do t'i cekim në trajtë të shkurtuar brenda tekstit pa mos lëshuar poshtëshënim.

⁶ Po aty, f. 100.

⁷ Walzer, Richard, *Al-Farabi On the Perfect State*, përkthyer në turqisht nga A. Arslan dhe bashkangjitur përkthimit të veprës *El-Medīnetü 'l-Fazıla* si interpretim dhe sqarim të saj, f. 242-243.

* “Ashtu si Platoni edhe Aristoteli nuk bën ndonjë dallim të qartë midis shtetit dhe shoqërisë.” Swingewood, Alan, *Sosyologjik Düşüncenin Kısa Tarihi*, Ankara, bot. Bilim ve Sanat, 1998, f. 23.

(*el-medīnetu'l-fādileh*) është ai banorët e të cilit bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në arritjen e lumturisë; shoqëri e përkryer është ajo individët e së cilës i ndihmojnë njëri-tjetrit në arritjen e lumturisë; popull i përkryer është ai qytetet e të cilit i ndihmojnë njëri-tjetrit për arritjen e lumturisë; po kështu, shteti i përkryer universal lind atëherë kur popujt që ai i ngërthen në vetvete e ndihmojnë njëri-tjetrin në arritjen e lumturisë.”⁸

Megjithëse Farabiu i ndjek filozofët e vjetër grekë, kryesisht Platonin dhe Aristotelin kur thekson se njeriu për nga natyra ka prirje që të jetojë në shoqëri, përsëri, me këtë që tha më lart, jepet të kuptohet se formimi i shoqërisë (shtetit) nuk lind si rezultat i një procesi natyror, porse ai mbështetet në vendimin dhe përcaktimin e drejtë të individëve të saj. Këtu peshë të rëndësishme paraqet vullneti dhe zgjedhja e individëve nëse ata njëmend janë orientuar drejt së mirës apo së keqes, sepse tekefundit edhe fati i shoqërisë (shtetit) varet prej këtij përcaktimi. Nga ky aspekt tanimë nuk është me rëndësi madhësia e shoqërisë, nëse ajo do të jetë një qytet, një perandori apo edhe një shtet universal. Duke i lënë mënjanë dallimet e madhësisë së shoqërisë, Farabiu së pari i rreket shtetit më të përkryer (ideal), kurse më pas i trajton edhe shtetet e prishura në forma të ndryshme si rezultat i zgjedhjes së synimeve të gabueshme e bashkë me këto edhe veprimeve që korrespondojnë me këto synime lidhur me jetën në përgjithësi.⁹

Shteti ideal dhe udhëheqësi i tij

1. Shteti ideal.* Shteti më i mirë mbështetet në drejtësinë e vërtetë, në barazinë përpjesëtimore. Në këtë shtet secili individ e kryen detyrën (rolin) që mund ta realizojë për nga vetë natyra dhe si rezultat i kësaj zë shkallën (pozitën) që e meriton. Në momentin kur ky shtet e humb këtë baraspeshë dhe fillon të administrohet në bazë të një drejtësie të rrejshme, ai e humb karakterin e të qenët ideal.¹⁰

Farabiu, strukturën dhe funksionimin e shtetit ideal i krahason me ato të një organizmi të shëndoshë dhe me sistemin hierarkik të mbarë gjithësisë. Sundimin natyror që ia përshkruan kosmosit dhe strukturës së trupit të njeriut, tani e vlerëson si një analogji dhe model për ligjësitë e shoqërisë, duke saktësuar edhe një herë se shoqëria nuk lind vetvetiu, porse ajo krijohet si rezultat i përpjekjeve të vetëdijshme të individëve. “Qyteti i virtytshëm (ideal) i përngjan një organizmi të plotë e të shëndoshë organet e të cilit bashkëveprojnë për ta mbajtur në jetë dhe në gjendje të shëndoshë qenien e gjallë, (*Shteti*, V, 462 cd). Tani, organet e trupit janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe kanë natyra krijimi po të këtilla. Në mesin e tyre gjendet një organ udhëheqës (zemra) dhe organe të tjera që për nga shkalla janë të përafërta me të. Çdonjëra prej këtyre organeve për nga natyra është e pajisur me një forcë përmes së cilës e kryen detyrën e vet sipas qëllimit të këtij organi udhëheqës. Pos këtyre ka edhe disa organe që për nga natyra janë të pajisura me forca përmes të cilave i kryejnë detyrat e tyre sipas qëllimeve të këtyre organeve të fundit, që për nga rangu vinin menjëherë pas organit udhëheqës. Këto organe për nga rangu vijnë të dytat. Ka edhe

⁸ Farabiu, po aty, f. 100-101.

⁹ Walzer, R., po aty, f. 246-247.

* Ndër filozofët që kanë shkruar për shtetin ideal, gjegjësisht utopist, kanë qenë Platoni me veprën *Shteti (Politeia)*, Thomas More, *Mbi rregullimin më të mirë shtetëror dhe mbi ujdhesën e re Utopia (De optimo rei publicae statu, de qua nova insola Utopia)*, Tommaso Campanella, *Qyteti i diellit (Civitas Solis)*, Frano Petriq, *Qyteti i lumtur (La città felice)*, Francis Bacon, *Atlantida e re (New Atlantis)* etj. Më gjerësisht shih: Недельковик, Душан, *Историја на Филозофијата (Скопски Предавања)*, v. I, Shkup, bot. Македонска Книга, 1984, f. 107, 269, 289.

¹⁰ Walzer, R., po aty, f. 247; Farabiu, po aty, f. 130-132.

organe të tjera që veprojnë sipas qëllimeve të këtyre organeve të rangut të dytë dhe vazhdon kështu me radhë deri te organet që vetëm u shërbejnë organeve të tjera e kurrsesi nuk udhëheqin. Po e njëjta gjendje vlen edhe për qytetin. Edhe pjesët e tij për nga krijimi dhe për nga aftësitë natyrore dallojnë prej njëra-tjetrës. Edhe në qytet ka një njeri udhëheqës pranë të cilit qëndrojnë njerëz të tjerë që për nga rangu ndodhen afër tij. Çdonjëri prej këtyre individëve zotëron një aftësi dhe fuqi përmes së cilës vepron sipas qëllimit të udhëheqësit. Këta njerëz bëjnë pjesë në rangun e parë. Nën këta vijnë disa të tjerë që veprojnë sipas qëllimeve të të parëve dhe e përbëjnë rangun e dytë. Kjo vazhdon kështu teposhtë deri te grupi i njerëzve që veprojnë sipas të tjerëve, por që nën ta nuk ka më ndonjë grup tjetër që do të vepronte sipas tyre. Këta të fundit, pra, janë shërbëtorë të të tjerëve, por të cilëve nuk u shërben kush. Prandaj ata janë gjërat më të pavlefshme që ndodhen në shkallën më të ulët. Mirëpo, duhet patur parasysh me këtë rast se organet e trupit janë të natyrshme dhe se forcat që i zotërojnë ato janë gjithashtu të natyrshme, kurse, nga ana tjetër, edhe pse pjesët e qytetit janë të natyrshme, aftësitë dhe fuqitë përmes të cilave këto pjesë i kryejnë detyrat e tyre në qytet nuk janë të natyrshme, por të vullnetshme. Përballë forcave natyrore të organeve të trupit qëndrojnë aftësitë dhe fuqitë e vullnetshme të pjesëve të qytetit.”¹¹

Një krahasim tjetër për ta shfaqur më qartë strukturën e shtetit (shoqërisë) Farabiu e zhvillon me sistemin hierarkik të kosmosit duke u mbështetur në idetë metafizike të tij.¹²

Në veprën e tij *Fusūlu'l-Medenijj* strukturën e shtetit ideal Farabiu e përshkruan të përbërë prej pesë klasash, përkundër shtetit ideal të Platonit që përbëhej prej tri syresh. Në kulmin e kësaj piramide pesëklasëshe qëndrojnë *shembullorët*, respektivisht filozofët, intelektualët dhe “burrat e ideve” në punët e mëdha. Klasën e dytë e përbëjnë *gjuhëtarët* (*dhevū'l-elsineh*) ku bëjnë pjesë oratorët (*el-hutabā* dhe *el-bulagā*), poetët (*esh-shu'arā*), muzicientët (*el-mulahhinūn*), njerëzit e fesë (*hameletu'd-dīn*), shkrimtarët (*el-kuttāb*) etj. Klasën e tretë e përbëjnë ata që merren me matematikë dhe me degët e saj të cilët Farabiu i quan *el-mukaddirūn* (*matës, caktues*). Këtu bëjnë pjesë matematikanët, aritmetikanët (*el-hussāb*), gjeometrët, fizicientët, astronomët (*el-munexhchimūn*) dhe të përngjashëm me këta të cilët merren me disa arte të larta.* Të katërtën e përbëjnë rojtarët (*el-muxhāhidūn*) bashkë me ushtarët. Klasa e pestë përbëhet prej njerëzve që merren me fitimin material (*el-malijjūn*), me artin ekonomik dhe me fitimin e kapitalit të shtetit (*muktesibū emvāli'l-medīneh*). Këtu bëjnë pjesë të gjithë ata që merren me aktivitete ekonomike në shoqëri si: bujqit, blegtorët, tregtarët dhe “të përngjashmit me ta”.¹³

Duke dashur të vë në dukje koherencën që ekziston ndërmjet individëve të shoqërisë (qytetarëve / shtetasve) dhe ndërmjet klasave të saj, Farabiu thekson: “Ashtu siç ka ca gjëra të përbashkëta që i di dhe i punon mbarë popullata e qytetit të virtytshëm, po ashtu ka edhe ca gjëra të tjera që i di dhe i punon çdonjëra prej klasave, (*Shteti*, II, 370 cd). Secili prej këtyre individëve shkallën e lumturisë e arrinë ose përmes lidhjes me tjetrin ose përmes lidhjes me klasën së cilës i takon. Nëse secili prej tyre sillet në këtë mënyrë, atëherë këto sjellje e qëndrime do t'i përfitojnë atij një

¹¹ Farabiu, po aty, f. 101-102. Krahaso këtë analogji të Farabiu me teorinë organike të shkollës biologjiste në sociologji të përfaqësuar nga O. Comte, H. Spencer, Liliënfeld, Shäffle etj., në Fiamengo, Ante, *Bazat e sociologjisë së përgjithshme*, Prishtinë, bot. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1984, f. 61; Kösemihal, Nurettin Şazi, *Sosyoloji Tarihi*, Stamboll, bot. Remzi, 1995, f. 54-56.

¹² Farabiu, po aty, f. 104. Për sistemin metafizik të Farabiu më gjerësisht shih: Corbin, Henry, *Historia e filozofisë islame*, Shkup, bot. Logos-A, 1997, f. 174-176; Sharif, M. M., po aty, v. I, f. 462-464; etj. Për ngjashmëritë e krahasimit të Farabiu midis shtetit (shoqërisë) dhe rendit kosmik me ato të shkollës mekaniste në sociologji shih: Fiamengo, A., po aty, f. 58-60; Kösemihal, N. Ş., po aty, f. 36-46.

* Këto tri klasat e para, te *Shteti* i Platonit janë të përmbledhura në një klasë të vetme të filozofëve- mbretër.

¹³ Farabiu, *Fusūlu'l-Medenijj*, Bodleian MS, Fol. 97 a, sipas Sharif, M. M., po aty, f. 119-120.

aftësi shpirtërore të lartë e të virtytshme dhe sa më shumë që t'i përsërisë e t'i vazhdojë ato aq më tepër do t'i forcohet dhe përsoset kjo aftësi. Me këtë del në shesh edhe fuqia edhe përkryerja e vetë individit. Kështu, p.sh., përsëritja e rregullt e aktiviteteve që kanë të bëjnë me bukurshkrimin njeriut ia shtojnë përkryerjen në këtë art dhe sa më shumë që t'i përsërisë këto aktivitete aq më tepër do të forcohet dhe përsoset edhe arti që i lind këto aktivitete, (*Shteti*, II, 374 bcd). Me këtë shtohet edhe kënaqësia që lind nga kjo aftësi e shpirtit, po edhe kënaqësia e dashuria që e ndjen njeriu ndaj kësaj aftësie. E njëjta vlen edhe për aktivitetet përmes të cilave arrihet lumturia (*esse'ādeh*). Sa më tepër të shtohen dhe përsëriten këto aktivitete, sa më gjatë dhe vazhdimisht t'i zbatojë njeriu ato, aq më shumë lartësohet dhe përkryhet shpirti i cili për synim ka arritjen e lumturisë. Kjo vazhdon kështu derisa shpirti ta arrijë pikën, shkallën në të cilën nga aspekti i përkryerjes nuk do të ndjejë nevojë për materien. Në këtë pikë shpirti pavarësohet tërësisht prej materies dhe nuk zhduket me zhdukjen e materies, po as që ndjen edhe nevojë për të për vazhdimin e ekzistimit të tij.”¹⁴

Me rëndësinë që Farabiu i jep ndarjes së shtetit në klasa dhe specializimit të individëve të shoqërisë në lëmi dhe arte të ndryshme si kusht për arritjen e lumturisë kulmore, ai i vë bazat e asaj që më vonë do të quhet teoria e ndarjes së punës shoqërore të cilën E. Durkheimi do ta konsiderojë si faktor vendimtar në transformimin shoqëror.*

Edhe pse Farabiu e ka patur në disponim përkthimin e *Shtetit* të Platonit nga një mik i veti, edhe pse ka deklaruar se banorët e qytetit ideal gjërat i kanë të përbashkëta ndërmjet vete, ai nuk bie në greminën e Platonit i cili çdo gjë – bile edhe gratë – e quan pronë të përbashkët të qytetarëve meshkuj. Ai është shumë i qartë kur thotë se krahas pronës së përbashkët në të cilën ka të drejtë të barabartë çdo individ dhe çdo klasë, duhet të lejohet edhe prona private krahas mundësisë për fitimin individual të diturisë (arsimit) dhe krahas fushës për veprim individual të qytetarëve.¹⁵ Nga kjo shihet se Farabiu jo vetëm që e njuh individualizmin si një propozim të denjë për lëvdata, por edhe “komunizmi” i tij është i kundërt me idenë e grekëve antikë, gjegjësisht me të Platonit sipas së cilës qeniet njerëzore do të merrnin forma figurash shahu pa kurrnjë karakter individual të vetin krahas individualitetit të tyre si anëtarë të ‘qytetit’.¹⁶

2. Udhëheqësi i shtetit ideal. Është e qartë, sipas Farabiut, se çdokush nuk mund të udhëheqë me shtetin ideal, sepse njerëzit dallojnë prej njëri-tjetrit për nga aftësia intelektuale, fuqia fizike, kryerja e veprimeve morale dhe për nga arritja e shprehive të larta të të menduarit, perceptuarit, vullnetit dhe veprimit, (*Shteti*, II, 370 b). Në çdo pjesë të jetës e të arteve personi më i fortë që dallohet me karakteristika të veçanta dhe i cili di, vepron dhe orienton është udhëheqësi i asaj pjese. Të tjerët janë të nënshtruar. Udhëheqësi ose është i pari në rang dhe nuk i nënshtrohet kujt ose është i dyti sipas radhës i cili udhëheq me disa, por i cili edhe i nënshtrohet dikujt.¹⁷

Arsyen pse çdokush nuk mund të bëhet udhëheqës i shtetit ideal Farabiu e shpreh edhe kështu:”Sepse udhëheqësia (*er-rijāseh*) fitohet në dy mënyra: a) udhëheqësi në fjalë për nga natyra duhet të jetë i aftë për të udhëhequr, dhe b) ky person duhet t'i fitojë aftësitë dhe qëndrimet e vullnetshme lidhur me udhëheqjen. Këto aftësi dhe qëndrime, ndërkaq, lindin dhe zhvillohen te

¹⁴ Farabiu, *el-Medīneh...*, f. 113-114.

* Emile Durkheimi kësaj çështjeje i kushton një vepër të veçantë të titulluar *Mbi ndarjen e punës shoqërore* (*De la Division du Travail Social*, 1893).

¹⁵ Farabiu, po aty, f. 113; Sherwani, Haroon Khan, *Studies in Muslim Political Thought and Administration*, Lahorë, bot. Sh. Muhammad Ashraf, 1970, f. 79.

¹⁶ Sherwani, H. Kh., po aty.

¹⁷ Farabiu, *es-Siyāseh...*, f. 84.

njerëzit që për nga natyra kanë prirje për të udhëhequr.”¹⁸ Me këtë konstatim Farabiu që para një mileniumi i ka gjetur zgjidhje problemit që sot trajtohet sidomos nga psikologjia sociale e që ka të bëjë me konceptimin e liderit të grupit, konkretisht nëse liderin e krijojnë karakteristikat dhe nevojat e rrethit (shoqërisë), gjegjësisht arsimi, apo ai këto aftësi për të udhëhequr një grup i posedon *a priori*, që nga lindja. Farabiu, siç u pa më lartë, e zgjedh modelin e tretë sipas të cilit lider është ai që më së miri i përmbush dhe i mbulon nevojat e grupit. Elementet përbërëse të këtij ndikimi reciprok janë nevojat e grupit, nga njëra anë, dhe veçoritë personale të liderit, nga ana tjetër.¹⁹

“Udhëheqësi i parë i qytetit shembullor (ideal) është ai që në çdo aspekt është udhëheqës. Profesionin e tij duhet t’i tejkalojë të gjitha të tjerat duke anuar kah përsosmëria dhe duke i orientuar të gjitha aktivitetet e shtetit ideal drejt arritjes së lumturisë. Ky njeri nuk i nënshtrohet askujt prej njerëzve. Është i përkryer me të gjitha virtytet, prandaj është edhe intelekt (*el-‘akl*) edhe inteligjibil (*el-ma’kūl*) në aktualitet. Zotëron aftësi imagjinative aq të përkryera saqë, qoftë në gjumë qoftë zgjuar, mund t’i arrijë partikularitetin përmes Intelektit aktiv (*el-‘akl el-fa’āl*) ose ashtu siç janë në vetvete ose në mënyrë figurative, ndërkaq inteligjibilitet i arrinë vetëm në mënyrë figurative. Në qoftë se Intelekti aktiv shfaqet në të dyja pjesët e aftësisë racionale – edhe në atë spekulative edhe në atë praktike – atëherë ky person (udhëheqësi) fillon të pranojë shpalljen (*el-vahj*) në aftësinë e tij imagjinative. Në këtë moment Zoti, i Lartësuar dhe Fisnik, i dërgon shpalljen përmes Intelektit aktiv. Po nëse Intelekti aktiv atë që e pranon prej Zotit ia dërgon Intelektit pasiv (*el-‘akl el-munfa’il*) përmes Intelektit të fituar (*el-‘akl el-mustefād*) e pastaj ia dërgon edhe aftësisë imagjinative, atëherë ky person me anë të asaj që i ka zbritur intelektit të tij pasiv bëhet filozof, i urtë; ndërkaq me anë të asaj që i ka zbritur aftësisë së tij imagjinative bëhet profet (pejgamber), lajmëtar për të ardhmen dhe shpallës i partikularieve ekzistuese, pasi ai këto i mëson prej Zotit. Ky njeri është në shkallën më të lartë të njerëzimit dhe të lumturisë. Shpirti i tij sikur është njësuar me Intelektin aktiv. Ai është një njeri që e njeh çdo aktivitet përmes të cilit mund të arrihet lumturia. Pikërisht ky njeri është sundimtari të cilin nuk mund ta sundojë asnjëri. Ai është *imāmi* (udhëheqësi), është kryetari i parë i qytetit të virtytshëm (*er-re`isu`l-evvel*), është mbreti (*el-melik*) i popullit të virtytshëm dhe i mbarë botës së banueshme”.²⁰

Në konceptimin e tij lidhur me liderin Farabiu përdor terma të literaturës islame si: Intelekt aktiv (*Rūhu`l-Kudus / Xhebraili*), shpallje (*el-vahj*), pejgamber (*en-nebijj*) etj. Këtu gërshetohen idetë e tij filozofike me ato fetare, sidomos në konceptimin e udhëheqësit si filozof-pejgamber (te Platoni filozof-mbret; *Shteti*, V, 473 d), i cili pos tjerash pranon edhe shpallje prej Zotit, konceptim ky që sot në njëfarë dore mund të hedhë dritë mbi relacionin shtet – fe, shtet fetar, shtet laik etj.

Për Farabiun personi që do të udhëheqë me shtetin ideal për nga natyra duhet të dallohet me këto dymbëdhjetë veçori ku bashkohen ato fizike, intelektuale dhe etike: “1. Të jetë i plotë dhe i shëndoshë fizikisht që të mund çdo organ i tij t’i kryejë funksionet që i bart. Kur të dëshirojë të bëjë një punë me cilindo organ, të mund këtë ta bëjë pa vështirësi, 2. Për nga natyra duhet të ketë aftësinë për ta kuptuar dhe perceptuar mirë çdo gjë që i thuhet; duhet ta kuptojë këtë sipas qëllimit të folësit ose sipas vetë logjikës së gjësendeve për të cilat flitet, 3. Duhet të ketë aftësinë e nxënies përmendsh (*el-hifdh*) të gjërave që i ka kuptuar, i ka parë, i ka dëgjuar, i ka perceptuar

¹⁸ Farabiu, *el-Medīneh...*, f. 104-105.

¹⁹ Më gjerësisht për konceptimin e liderit nga aspekti socio-psikologjik shih: Dragoti, Edmond, *Psikologjia sociale*, Tiranë, bot. Toena, 1999, f. 476-482.

²⁰ Farabiu, *el-Medīneh...*, f. 105-107. Për sistemin epistemologjik dhe psikologjik si dhe për teorinë e profetësisë (*en-nubuvveh*) të Farabiut më gjerësisht shih: Farabiu, po aty, f. 75-98; Fahri, Macit, *Islām Felsefesi Tarihi*, Stamboll, bot. İklim, 1992, f. 112-115; Sharif, M. M., po aty, f. 464-469; Corbin, H., po aty, f. 175-178.

dhe s' duhet të harrojë thujasë asgjë, 4. Duhet të jetë i zgjuar dhe shumë i mprehtë; kur të gjejë provën më të vogël për një çështje, atë duhet ta kuptojë në bazë të asaj që i ofron prova, 5. Duhet të ketë aftësinë e të folurit bukur (oratorinë) përmes së cilës do të mund ta shprehë qartë atë që e ka ndër mend, 6. Duhet ta dojë dhe t'i kushtohet tërësisht mësimin (*et-ta'al-lum*), vështirësitë e tij nuk duhet t'i konsiderojë të pakapërcyeshme, 7. Për nga natyra duhet ta dojë të vërtetën dhe njerëzit e sinqertë, kurse duhet ta urrejë rrenën dhe rrenacakët, 8. Për nga natyra duhet të mos shkojë pas pasioneve të hajes, pijes dhe seksit; duhet t'i ikë bixhozit dhe kënaqësive që lindin prej këtyre pasioneve, 9. Duhet të jetë shpirtmadh (*kebīru'n-nefs*) dhe duhet ta dojë nderin dhe respektin (*el-kerāme*); shpirti i tij duhet të jetë mbi gjërat që për nga natyra janë të shëmtuara dhe të poshtra; duhet të shkojë pas sendeve më të larta e më fisnike, 10. Në syrin e tij gjërat si ari, argjendi e të tjera synime të kësajbotshme duhen qenë të pavlefshme, 11. Për nga natyra duhet ta dojë drejtësinë (*el-'adāleh*) dhe të drejtin; duhet t'i urrejë ata që ushtrojnë dhunën (*el-xhebr*) dhe padrejtësinë (*edh-dhulm*); duhet të jetë i matur ndaj vetvetes dhe të tjerëve e kështu t'i porosisë edhe të tjerët; duhet t'i dhimbsen njerëzit e shtypur; duhet të mbështesë çdo gjë të bukur, të drejtë e të mirë; nuk duhet të bëjë inat kur të ftohet në drejtësi dhe në zbatimin e saj; përkundrazi, kur të ftohet në padrejtësi dhe në të keqe duhet të ngulë këmbë e të jetë i vendosshëm në mosrealizimin e tyre, 12. Pastaj, të jetë i vendosur dhe i qëndrueshëm në gjërat që konsideron se duhen bërë dhe ato duhet t'i realizojë guximshëm pa shfaqur frikë dhe dobësi”²¹, (*Shteti*, VI, 485-486).

Ashtu si Platonit edhe Farabiut iu desh të pranonte se paraqitja e njerëzve të këtillë të jashtëzakonshëm qofshin si filozofë-pejgamberë qofshin vetëm si filozofë, është një rast shumë i rrallë. Për këtë arsye ai tërheq vëmendjen drejt ushëheqësisë së dytë dhe të tretë më të mirë dhe ashtu siç patën vepruar më parë Platoni* e të tjerët, detyrohet t'i marrë parasysh edhe mundësitë që i shtron jeta reale për ta realizuar programin e tij. “Vështirë është që të gjitha këto karakteristika t'i zotërojë vetëm një person dhe brenda një shekulli mund të haset vetëm një herë në njeri me tipare të këtilla natyrore, të lindura. Nëse në qytetin e virtytshëm haset një person i këtillë dhe pasi të rritet i plotëson gjashtë nga dymbëdhjetë kushtet që i përmendëm më lart – ose i plotëson pesë të tilla pos aftësisë për t'i bindur njerëzit përmes fuqisë imagjinuase – ky njeri do të bëhet udhëheqës. Nëse në ndërkohë nuk haset njeri i këtillë, mirëpo në të kaluarën në këtë qytet ka patur një brez udhëheqësish me tipare të këtilla që kanë ndjekur njëri-tjetrin në kohë, atëherë do të përvetësohen e ruhen ligjet, rregullat dhe zakonet që i kanë vënë këta të parët.

Udhëheqësi (i dytë) që pason atë të parin kur të rritet duhet të shquhet së paku edhe me këto gjashtë tipare: 1. Ai duhet të jetë i urtë, filozof, 2. Duhet t'i dijë dhe ruajë ligjet, rregullat dhe metodat e udhëheqësve të parë për drejtimin e qytetit, 3. Duhet të jetë i aftë në nxjerrjen (deduktimin) e ligjeve të reja për çështjet që nuk i kanë trajtuar të parët, 4. Duhet të zotërojë aftësi rezonuese dhe një intelekt të lartë praktik (*er-ravijeh*) për të gjykuar drejtë për çështjet që nuk kanë qenë prezente më parë për të cilat do të kishin sjellë ligje adekuate të parët, 5. Duhet të shquhet me aftësinë për ta bindur masën lidhur me ligjet e të parëve dhe të vetat që i ka sjellë sipas metodave të udhëheqësve të parë, 6. Duhet të jetë i shëndoshë fizikisht që të mund t'i kryejë aktivitetet ushtarake me mjeshtri, qoftë kur bëhet fjalë për artet luftarake shërbyese, qoftë për ato komanduese.”²²

²¹ Farabiu, po aty, f. 107-108.

* “Nga fundi i jetës Platoni megjithkëtë kuptoi se *Politeia* (*Shteti*) ishte vetëm një ide iluzore dhe se duhet t'u përshtatet mundësi të ekzistues njerëzore dhe shoqërore. Fryt i këtyre përvojave të mëvonshme janë *Ligjet* (*Nomoi*) e tij.” Gërliq, Danko, *Leksikon i filozofëve*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1986, f. 356-357.

²² Farabiu, po aty, f. 108-109.

I vetëdijshëm se ndoshta edhe kjo s'mund të realizohet Farabiu vazhdon të kërkojë zgjidhje duke thënë: "Në qoftë se të gjitha këto kushte nuk i zotëron një person i vetëm, porse ndodhet një që është vetëm filozof dhe një tjetër që shquhet me tiparet e tjera, atëherë të dy këta do të udhëheqin qytetin".²³

Në qoftë se merret vesh se edhe ky plan për administrim dykrerësh (*er-re`īsān / diarchy*) është i perealizueshëm, atëherë ekziston edhe një rrugë për ruajtjen e urtësisë (filozofisë) e cila do të duhej të sundonte në shtetin ideal. Baza e këtij planit të fundit është kjo: secila nga gjashtë tiparet e sipërpërmendura mund të përfaqësohet nga njerëz të ndryshëm të cilët do të veprojnë në një harmoni të plotë e të përkryer si një grup i udhëheqësve më të mirë. Ky administrim quhet "administrimi i më të mirëve" (aristokraci), sepse këta janë njerëzit më të mirë dhe synojnë më të mirën e shtetit. Farabiu shprehet kështu: "Nëse këto kushte ndodhen të shpërndara ndër njerëz të ndryshëm, kështu që filozofia haset të njëri, tipari i dytë te i dyti...tipari i gjashtë te i gjashti dhe nëse këta njerëz merren vesh mes vete, atëherë të gjithë këta përnjëherësh do të jenë udhëheqësit më të mirë."²⁴

Tani duket e qartë se Farabiu insiston në mendimin se shteti ideal do të mund t'i shpëtonte shpërbërjes vetëm nëse filozofi, në çfarëdo forme qoftë, merr pjesë në administrimin e tij, përndryshe ky shtet do të mbetet pa udhëheqës. Nëse nuk gjendet ndonjë filozof që do të merrte pjesë në qeverisjen e tij, ai shtet domosdo do të shkatërrohet. Shteti më i mirë mund të ekzistojë vetëm në saje të baraspeshës që do të krijohej midis fuqisë politike dhe urtësisë filozofike, (*Shteti*, V, 473 de). "Në qoftë se në ndërkohë filozofia (urtësia / *el-hikmeh*) nuk konsiderohet si pjesë përbërëse e qeverisjes, atëherë qyteti i virtytshëm do të mbetet pa udhëheqës, bile edhe nëse gjenden tiparet e tjera në të; kështu, njeriu që do të merrej pastaj me qeverisjen e qytetit nuk do të ishte udhëheqës, kurse popullata e qytetit do të ndeshet me rrezikun e vetëshkatërrimit. Nëse nuk gjendet një filozof që do të ishte pranë udhëheqësit praktik të këtij qyteti, pas pak kohësh nuk do të vonojë shkatërrimi i këtij qyteti."²⁵

"Personat që njëri pas tjetrit dhe në kohë të ndryshme udhëheqin qytetet e virtytshme janë si një shpirt i vetëm, si një udhëheqës i vetëm i cili përgjatë tërë kohës mbetet i njëjtë. E njëjta vlen edhe për një grup udhëheqësish të një ose të më shumë qyteteve që sundojnë brenda një kohe. Edhe ata janë sikur një udhëheqës dhe sikur një shpirt i vetëm. Si një shpirt i vetëm që mbetet i tillë për gjithë kohën janë edhe njerëzit që pasojnë njëri-tjetrin në kohë të ndryshme dhe që u takojnë klasave të ndryshme të një qyteti të këtillë. E njëjta vlen edhe për shpirtat e njerëzve të një klase, qoftë kjo klasë udhëheqëse qoftë shërbyese, edhe ata janë sikur një shpirt i vetëm."²⁶

Shtetet joideale - tipologjia dhe veçoritë e tyre

Përkundër shtetit ideal të cilin e drejtonte, ashtu siç u përmend më lart, udhëheqësi ideal i cili me veçoritë dhe tiparet që i kishte angazhohej për lumturinë dhe mirëqenien e shtetasve të tij,

²³ Po aty, f. 109. "Megjithëse për qëllime të tjera fare, trajtimi i çështjes së ekzistimit të dy *imāmëve* të një kohe, qofshin sunnitë apo shiitë, nuk është një problem i panjohur për politikën aktuale të botës islame dhe për diskutimet që janë zhvilluar në të kaluarën. Në kohën e Farabiuat ndër qarqe shiite mendohej si i mundshëm ekzistimi i njëkohshëm i dy e më tepër *imāmëve* prej të cilëve njëri ishte që flet (*en-nātik*) e tjetri që hesht (*es-sāmit*).” Walzer, R., po aty, f. 266.

²⁴ Farabiu, po aty, f. 110.

²⁵ Po aty.

²⁶ Farabiu, po aty, f. 112-113.

Farabiu vë në dukje se ekzistojnë edhe shtete të tjera të cilat për objektiv të tyre nuk e kanë arritjen e lumturisë dhe as që mërziten për njohjen e saj. Farabiu konstaton katër lloje shtetesh të gjymta, të papërkryera, joideale. Kriteri i vetëm për një tipologji të këtillë dhe për ndarjen / dallimin e këtyre të fundit prej shtetit ideal është fakti se edhe banorët e këtyre shteteve edhe udhëheqësit / sundimtarët e tyre gjenden në nivelin / standardin e filozofisë së vërtetë dhe se për synim të tyre kanë objekte të tjera veç lumturisë dhe së mirës së vërtetë.²⁷

“Qytetet e kundërta me qytetin e virtytshëm janë: qyteti injorant (*el-xhāhilijeh*), qyteti i prishur (*el-fāsikah*), qyteti me karakter të ndryshuar (*el-mubeddeleh*) dhe qyteti që s’e ka gjetur rrugën e drejtë, i lajthitur (*ed-dāl-leh*).”²⁸ Gjatë këtij klasifikimi Farabiu nuk aludon qartë në ndonjë shtet të veçantë apo në disa rrethana të posaçme politike, porse ai këto i parashtron si dukuri që kanë karakter universal.

“**Qyteti injorant** (*el-medīnetu’l-xhāhilijeh*), është qyteti popullata e të cilit nuk e njeh lumturinë dhe nuk është e informuar për të. Edhe nëse u ofrohen njohuri lidhur me lumturinë as nuk do ta kuptojnë e as do t’i besojnë. Sendet e vetme që atyre u duken të mira janë disa që për nga forma supozohet se janë të tilla, si: shëndeti, pasuria, kënaqësitë e shqisave dhe epsheve, liria e njeriut në ndjekjen e dëshirave dhe pasioneve, gëzimi i respektit dhe nderit, të cilat atyre u shërbejnë si synime jetësore. Sipas popullit të qytetit injorant secila prej këtyre paraqet një lloj lumturie, kurse lumturia më e madhe dhe më e plotë është tërësia e të gjitha këtyre të mirave. Sendet e kundërta me to, pra: sëmundja, varfëria, privimi nga kënaqësitë shqisore dhe nga ndjekja e pasioneve janë sende të këqija.”²⁹ Shembulli i parë i “qytetit injorant” haset te librat VIII dhe IX të *Shteti* i Platonit. Mirëpo, këtu Farabiu e ka ndryshuar radhitjen e listës së këtyre shteteve si dhe ka shtuar tipe të tjera.

“Qyteti injorant më tej ndahet në një sërë qytetesh të tjera: njëri prej tyre është *qyteti i domosdoshëm* (*el-medīnetu’d-darūrijeh*). Ky është qyteti banorët e të cilit mjaftohen me sasinë e domosdoshme të hajes, pijes, mbathjes, strehimit dhe seksit për vazhdimin e ekzistimit të tyre fizik dhe të cilët i ndihmojnë njëri-tjetrit në arritjen e këtij synimi, (*Shteti*, II, 369 d). Një tjetër është *qyteti i këmbimit, kapitalist (?)* (*medīnetu’l-beddāleh*), banorët e të cilit bashkëpunojnë në arritjen dhe fitimin e kapitalit dhe të pasurisë. Mirëpo, ata këtë nuk e bëjnë për hir të diçkaje tjetër, por vetëm pse pasurinë e konsiderojnë si synim të vetëm jetësor, prandaj edhe përpiqen që gjithnjë e më tepër ta shtojnë atë, (*Shteti*, VIII, 550 c; II, 372 a). Tjetri është *qyteti i banalitetit dhe i poshtërsisë* (*medīnetu’l-hassah ve’sh-shikveh*). Banorët e këtij qyteti për synim të tyre kanë hajen, pijen, marrëdhëniet seksuale, sidomos ndjenjën e kënaqësisë në gjërat që kanë të bëjnë me ndjenjat dhe imagjinatën. Në çdo formë dhe mënyrë ndjekin dëshirën dhe lojërat. Një qytet tjetër është *qyteti i ndershmërisë* (*medīnetu’l-kerāme*), banorët e të cilit për synim të tyre kanë ndihmën e ndërsjellë për fitimin e famës, lëvdatës, respektimit të fjalimeve dhe shkrimeve të tyre, nderimit të ndërsjellë ndër popuj. Në këtë qytet çdo individ dëshiron të gëzojë nder dhe respekt aq sa ndjen dashuri ndaj tyre apo aq sa i vjen dorësh t’i fitojë ato, (*Shteti* VII, 343 a). Një tjetër është *qyteti i fuqisë, dominimit* (*medīnetu’t-tegal-lub*). Qëllimi i banorëve të këtij qyteti është dominimi mbi të tjerët dhe pengimi i dominimit të të tjerëve mbi këta. Synimi i tyre i vetëm është arritja e kënaqësisë që do ta përjetonin nga një mbisundim i këtillë. Njëri prej tyre është edhe *qyteti demokratik* (*el-medīnetu’l-xhimā’ijeh*). Qëllimi i banorëve të këtij qyteti është arritja e lirisë që çdokush të mund ta bëjë atë që dëshiron pa mos i frenuar pasionet dhe dëshirat e veta në asnjë formë, (*Shteti*, VIII, 555 b-562 a).

²⁷ Walzer, R., po aty, f. 269.

²⁸ Farabiu, po aty, f. 110.

²⁹ Po aty.

Proporcionalisht me llojet e qytetit injorant ekzistojnë edhe udhëheqësit / sundimtarët e tyre. Secili prej tyre e drejton qytetin në të cilin sundon ai në mënyrë që do t'i realizonte dëshirat dhe synimet e veta. Ne këtu i klasifikuam synimet e këtyre qyteteve sipas dëshirave dhe sjelljeve të popullit injorant.

Qyteti i prishur (*el-medīnetu 'l-fāsikah*) posedon të njëjtat ide si të qytetit të virtytshëm (ideal). Ai e njeh lumturinë, Zotin e Lartësuar e Fisnik, qeniet e shenjta të shkallës së dytë, Intellektin aktiv dhe çdo gjë që mund të dijë e të besojë populli i qytetit të virtytshëm. Mirëpo, punët dhe sjelljet e banorëve të këtij qyteti janë të njëjtat me ato të qytetit injorant.

Qyteti me karakter të ndryshuar (*el-medīnetu 'l-mubeddeleh*) është qyteti që dikur ka patur ide dhe punë të njëjta me ato të qytetit të virtytshëm, mirëpo që tani ka ndryshuar dhe në vend të ideve dhe punëve paraprake shquhet me ide dhe punë të tjera fare.*

Qyteti i lajthitur (*el-medīnetu 'd-dāl-leh*) është ai që synon lumturinë në jetën e paskëtajshme, por që ushqen ide të gabuara e të rrezikshme lidhur me Zotin e Lartësuar e Fisnik, qeniet e larta të shkallës së dytë, Intellektin aktiv bile edhe nëse të njëjtat këto ide merren si simbole (*et-temeththulāt*) dhe përfytyrime (*et-tehajjulāt*) të lumturisë së vërtetë. Sundimtari i parë i këtij qyteti është një njeri që pretendon se i zbret shpallje (inspirim, *el-vahj*), ndonëse nuk është i tillë. Për hir të vërtetimit të këtij pretendimi ai nuk i ik as mashtrimit, as gënjeshtërisë e as tradhtisë.

Udhëheqësit e këtyre qyteteve janë të kundërt me ata të qytetit të virtytshëm, po edhe administrimi i tyre është i kundërt me atë të virtytshmit. E njëjta vlen edhe për të gjithë banorët që jetojnë nëpër këto qytete.”³⁰

Duke i trajtuar idetë e gabueshme të banorëve të këtyre qyteteve (shteteve) të cilët nuk e njohin apo nuk e zbatojnë të mirën e vërtetë (lumturinë) dhe të cilat ide mbështeten në ato të gabueshmet e të lashtëve (grekeve antikë)³¹, Farabiu hedh dritë mbi disa çështje sociale dhe politike nga jeta reale që më vonë po edhe sot janë trajtuar dhe trajtohen gjerë e gjatë ndër mendimtarë të ndryshëm. Kështu, ai flet për atë që sot në literaturën socio-politike quhet “formimi i shtetit / shoqërisë politike”, “kontrata sociale”, “formimi i grupeve shoqërore”, “proceset e interaksionit shoqëror” etj.

Fillimisht Farabiu e përmend idenë e gabuar të të parëve sipas së cilës: “Midis njerëzve nuk ekziston asnjëfarë dashurie dhe lidhmërie e ndërsjellë (*et-tahabbub* dhe *el-irtibāt*) natyrore apo e vullnetshme. Secili duhet ta urrejë tjetrin dhe mos ta pëlqejë atë. Dy persona vetëm në rast nevoje mund të bashkohen e të krijojnë lidhje reciproke. Ky bashkim i tyre mbështetet në marrëveshjen që njëri prej tyre të urdhërojë e tjetri t'i bindet urdhërit të të parit. Ky bashkim duhet të vazhdojë derisa të zgjasë nevoja për të dhe derisa të vazhdojë ta detyrojë këtë ndonjë rrezik i jashtëm. Mirëpo, në momentin kur të evitohet ky rrezik këta sërish duhet ta urrejnë njëri-tjetrin dhe të ndahen. Kjo është një sëmundje shtazarake (*dā'un seb'ijj*) që mbrohet ndër njerëz”³², (*Shteti*, IX, 588 e, 589).

Edhe një hajdut (vjedhës) i vetmuar bile “sipas mendimit të disave” ndjen nevojë për diçka, prandaj edhe parapëlqen një lloj bashkësie, mos më shumë një *domestica societas*. Kjo bashkësi

* Platoni për këtë tip shteti flet në librin VIII të *Shtetit*, kur e trajton mënyrën e shndërrimit të aristokracisë në timokraci.

³⁰ Farabiu, po aty, f. 110-112; Farabiu, *es-Siyāseh...*, f. 97-104.

³¹ Farabiu, *el-Medīneh...*, f. 125.

³² Po aty, f. 128.

mund të lindë në dy mënyra kryesore: ose si rezultat i dhunës dhe fuqisë (autokracisë) ose në saje të paqes së brendshme të grupit në fjalë.³³

“Sipas mendimit të disave bashkimi dhe tubimi i njerëzve duhet të realizohet me dhunë. Sipas kësaj, pra, një njeri që ndjen nevojën për ndihmës, me dhunë do ta përgjunjëzojë e do ta fusë në shërbim të tijin një grup njerëzish. Pastaj, përmes këtyre do t’i përgjunjëzojë e robërojë disa të tjerë...Dhe në fund arrin të fitojë një sërë ndihmësish të tubuar rreth tij në mënyrë hierarkike. Pasi t’i tubojë këta rreth vetes, i përdor si mjete për arritjen e synimeve të veta.”³⁴

Mënyra e dytë e formimit të shoqërive politike apo grupeve shoqërore mbështetet jo në luftën por në paqen, dashurinë dhe respektimin reciprok të individëve të tyre. “Disa të tjerë mendojnë se në botë duhet të sundojë lidhmëria, dashuria e ndërsjellë dhe uniteti. Mirëpo, këta nuk janë të një mendjeje sa i përket karakterit dhe natyrës së lidhjes që i bashkon njerëzit. Sipas disave ajo që i lidh njerëzit është *prejardhja e përbashkët e gjakut*. Bashkimi, uniteti, dashuria reciproke, bashkëpunimi në mundjen e të tjerëve dhe në pengimin e mundjes së këtyre nga ana e të tjerëve, janë rezultat i kësaj lidhjeje. Sepse shkaku i mospajtimit dhe i mospëlqimit të njëri-tjetrit është, pa dyshim, prejardhja jo e përbashkët e tyre. Lidhjen më të fortë e shkakton bashkimi në një gjak të afërt e të posaçëm. Sa më i largët dhe i përgjithshëm të jetë bashkimi në këtë gjak aq më e dobët do të jetë dhe lidhja reciproke.

Disa mendojnë se një lidhje e këtillë lind si rezultat i martesës së fëmijëve meshkuj të një grupi me fëmijët femra të një grupi tjetër. Kjo quhet *krushqi*.

Sipas disa të tjerëve kjo lidhje lind në bazë të *udhëheqësit të parë* i cili në fillim i ka tubuar njerëzit e pastaj është bërë lider i tyre. Ata në saje të këtij udhëheqësi janë forcuar, pasuruar dhe kanë arritur një mirësi tjetër të cilën banorët e qytetit injorant e njohin për të mirë.

Sipas një mendimi, bazën e kësaj lidhjeje e përbën *betimi, pakti dhe kontrata*. Me këtë çdo person e jep fjalën se nuk do t’i urrejë e nuk do t’i nënçmojë ata me të cilët lidh marrëveshje. Kështu, fuqia e njerëzve që i takojnë këtij grupi është bashkuar në mundjen e të tjerëve dhe në mbrojtjen e vetvetes.

Disa janë të mendimit se kjo lidhje mbështetet në *karakterin dhe temperamentin e përngjashëm* si dhe në *gjuhën dhe të folurit e përbashkët*. Ata mendojnë se këto tri veçori e krijojnë dallimin midis popujve (kombeve). Individët e çdo populli janë të lidhur ndërmjet vete me një lidhje të këtillë, prandaj ata duhet ta duan njëri-tjetrin dhe t’i urrejnë të tjerët, të huajt.”³⁵

Më pas Farabiu, gjithnjë duke i trajtuar idetë e gabueshme të shtetit joideal, bën një analizë lidhur me formimin e grupeve shoqërore, sidomos të atyre që sot në sociologji njihen si *grupe të para (primare) shoqërore*. “Një lidhje e veçantë është ajo që lind si rezultat i vendbanimit të përbashkët. Forma më e dukshme e kësaj është përbashkësia e një shtëpie. Pastaj pason përbashkësia e rrugës, e lagjes, e qytetit dhe e rrethinës së tij. Ekzistojnë edhe disa faktorë që ndikojnë në krijimin e një lidhjeje të pjesshme midis individëve të një grupi të vogël, midis disa personave dhe përfundimisht midis dy vetëve. Këta faktorë janë si p.sh. ndejtja bashkë për një kohë të gjatë, përbashkësia e hajes, pijes, profesionit, fatkeqësisë – sidomos nëse ajo është e llojit të njëjtë, sepse me këtë rast njerëzit e ngushëllojnë njëri-tjetrin – pastaj vjen përbashkësia e

³³ Walzer, R., po aty, f. 317.

³⁴ Farabiu, po aty.

³⁵ Po aty, f. 129-130.

pasioneve (dëshirave), e vendit dhe situatave kur njerëzit ndiejnë nevojë për njëri-tjetrin, si në rast të udhëtimeve të gjata e të rrezikshme tokësore apo ujore.”³⁶

Farabiu në njëfarë dore është edhe paralajmërues i Thomas Hobbes-it dhe J. J. Rousseau-së sa i përket teorisë së dorëheqjes së ndërsjellë prej të drejtave, gjegjësisht kontratës sociale, sipas të cilave teori “*Bellum omnium contra omnes*” (“Të gjithë janë në luftë kundër të gjithëve”) ose “*Homo homini lupus est*” (“Njeriu për njeriun është ujk”) dhe për të siguruar stabilitetin në shoqëri individët e saj heshtazi lidhin marrëveshje dhe heqin dorë nga disa të drejta të tyre dhe krijojnë shtetin.³⁷ “Të parët kështu kanë menduar: Në shitblerje, në kthimin prapë të emaneteve të pronarët e tyre, në mosmarrjen e ndonjë sendi të huaj me dhunë, në ikjen nga padrejtësia dhe në gjërat e tjera si këto për të cilat thuhet se janë “të drejta”, fjala “drejtësi” kryesisht përdoret për veprat që lindin nga frika dhe dobësia dhe në rast kur ndonjë rrezik i jashtëm kërkon të qenët “i drejtë”. Sepse këtu çdonjëri prej tyre – qoftë të bëhet fjalë për dy persona, qoftë për dy grupe – ose është i barabartë me tjetrin nga aspekti i forcës ose sundojnë radhazi njëri-tjetrin. Tani kjo gjendje vazhdon kështu edhe për një kohë dhe çdonjëri prej këtyre personave apo grupeve në fjalë i përjeton këto dy gjendje. Më pas kjo gjendje bëhet e padurueshme për të dyja palët. Atëherë ato afrohen dhe merren vesh për njohjen reciproke të të drejtave. Çdonjëra prej palëve heq dorë nga një pjesë e asaj për të cilën janë konfrontuar. Kështu ata e ndajnë atë ndërmjet vete. Me këtë ata i japin fjalën njëri-tjetrit se nuk do ta marrin me dhunë dhe pa pëlqimin e palës tjetër atë që ndodhet në duart e tjetrit.”³⁸

Ndër idetë e gabuara të banorëve të këtyre qyteteve Farabiu e përmend edhe atë që ka të bëjë me fenë dhe thuajse që më parë i kritikon Sigmund Freud-in, Karl Marxin e të tjerë mendimtarë si këta që kanë qëndrim negativ dhe përçmues ndaj fesë. “Të besosh se ekziston një Zot i vetëm që ka krijuar gjithësinë, se ekzistojnë qenie hyjnore të cilat i drejtojnë dhe i kontrollojnë të gjitha punët; të madhërosh (*et-ta’ dhīm*) Zotin dhe qeniet hyjnore; t’i adhurosh, lavdërosh e shenjtërosh ata; të besosh se njerëzit që vazhdojnë në këtë rrugë dhe që i braktisin të gjitha të mirat e kësaj bote do të shpërblehen me të mira të mëdha pas vdekjes; të besosh se nëse nuk i realizojnë këto dhe nëse i parapëlqejnë të mirat e kësaj bote do të dënohen pas vdekjes dhe do të ballafaqohen me gjëra të mëdha, të gjitha këto s’janë gjë tjetër veçse hile, mashtrime dhe gjepura që disa njerëz i përdorin kundër disa të tjerëve. Këto janë mashtrime dhe intriga të kurdisura nga njerëz që s’kanë guximin haptazi dhe duke luftuar sheshazi t’i fitojnë këto mirësi, janë kurthe që i përdorin ata që nuk kanë fuqi të luftojnë vetëm me forcat e tyre fizike pa ndihmën e të tjerëve. Ashtu siç gjuhen kafshët e egra, herë me ashpërsi e forcë dhe herë me mashtrime e kurthe, edhe këto gjëra (mirësi të kësaj bote) fitohen herë me forcë e herë me mashtrime dhe kurthe.”³⁹

“Këto dhe të përngjashme me këto janë ide prej injoranti që lindin në kokat e shumicës së njerëzve si rezultat i asaj që e shohin dhe vështrojnë te qeniet e kësajbotshme.”⁴⁰

³⁶ Po aty, f. 130.

³⁷ Sherwani, H. Kh., po aty, f. 70-71. Vepra më e njohur e Thomas Hobbes-it në këtë drejtim është *Leviathan, or the Matter, Form and Power of the Common-Wealth Ecclesiastical and Civil* (1651). Kurse J. J. Reussseau është i njohur me veprën e tij *De Contrat Social, ou principes de droit politique* (1762). Shih: Недельковик, Д., po aty, f. 295, 477; Gökberk, Macit, *Felsefë Tarihi*, Stamboll, bot. Remzi, 1996, f. 281,383.

³⁸ Farabiu, po aty, f. 132.

³⁹ Po aty, f. 133-134.

⁴⁰ Po aty, f. 135.

Bibliografia:

1. Corbin, Henry, *Historia e filozofisë islame*, Shkup, bot. Logos-A, 1997.
2. Dragoti, Edmond, *Psikologjia sociale*, Tiranë, bot. Toena, 1999.
3. Er, İzzet, *Din Sosyolojisi*, Ankara, bot. Akçağ, 1998.
4. Fahri, Macit, *İslam Felsefesi Tarihi*, Stamboll, bot. İklim, 1992.
5. Farabiu, *es-Siyāsetu 'l-Medeniyye veya Mebādiu 'l-Mevcūdāt*, përkth. në gj. turke M. Aydın dhe të tjerët, Stamboll, bot. Kültür Bakanlığı, 1980.
6. Farabiu, *el-Medīnetü 'l-Fāzıla (İdeal Devlet)*, përkth. në gj. turke Ahmed Arslan, Ankara, bot. Vadi, 1997.
7. Fiamengo, Ante, *Bazat e sociologjisë së përgjithshme*, Prishtinë, bot. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1984.
8. Gërliq, Danko, *Leksikon i filozofëve*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1986.
9. Gökberk, Macit, *Felsefe Tarihi*, Stamboll, bot. Remzi, 1996.
10. Kösemihal, Nurettin Şazi, *Sosyoloji Tarihi*, Stamboll, bot. Remzi, 1995.
11. Недељковиќ, Душан *Историја на Филозофијата (Скопски Предавања)*, v. I, Shkup, bot. Македонска Книга, 1984.
12. Platoni, *Shteti*, Prishtinë, bot. Rilindja, 1980.
13. Swingewood, Alan, *Sosyolojik Düşüncenin Kısa Tarihi*, përkth. në gj. turke Osman Akınhay, Ankara, bot. Bilim ve Sanat, 1998.
14. Sharif, M. M., *Historija Islamske Filozofije*, v. I-II, Zagreb, bot. August Cesarec, 1990.
15. Sherwani, Haroon Khan, *Studies in Muslim Political Thought and Administration*, Lahorë, bot. Sh. Muhammad Ashraf, 1970.

REZYME

Në të shumtën e studimeve dhe të kritikave shkencore lidhur me Farabiun, ai rëndom na del përpara vetëm si një filozof islam me pikëpamje filozofike të mbështetura në filozofinë antike greke dhe si një përkthyes dhe përcjellës i thjeshtë i saj duke e mospërfillur me këtë rast origjinalitetin e tij në këtë drejtim si dhe kontributin e tij në fushat tjera si në sociologji dhe politikë. Prandaj duke dashur të hedhim dritë edhe mbi këto aspekte të mendimit dhe përvojës së tij u munduam të shtjellojmë disa teori të tij lidhur me domosdoshmërinë e shoqërisë, ndarjen e saj në të përkryer e të papërkryer, krijimin e grupeve shoqërore, formimin dhe strukturën e shtetit, sundimtarin, kriteret për fuqinë udhëheqëse, integrimin e njerëzve në familje, grupe shoqërore, shtete, perandori etj. si dhe tema të tjera lidhur me këto. S'ka dyshim se disa prej teorive të tij në një farë mase mbështeten në mendimin grek, kryesisht në atë platonik dhe neo-platonik, që ka qenë në qarkullim në kohën e tij, mirëpo, nga ana tjetër, mund të shihet e të konstatohet se shumica e shkrimeve të tij mbështeten në vizionin e tij të kulluar dhe në përvojën e tij politike. Kështu, Farabiu paraqet vazhdimësi në vijën e gjatë historike të mendimit njerëzor dhe lirisht mund të radhitet, në mos themeluesit, së paku ndër përgatitësit e sociologjisë dhe teorisë politike.

Fjalët kyçe:

- njeriu si *zoon politikon*,
- qyteti i virtytshëm / shteti ideal,
- udhëheqësi i parë i qytetit të virtytshëm,
- qytetet e pavirtytshme / shtetet joideale.

(Ky tekst më parë është botuar në: Fakulteti i Shkencave Islame-Shkup, *PËRMBLEDHJE PUNIMESH*, Viti 1, Nr. 1, Shkup, 2002, f. 93-116)